




Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë/Ministarsvo Pravde/Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the Secretary General

ZSP- Nr. 160
Datë: 15/12/25

Në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare Nr.7/01 Mars 2019), në bazë të nenit 44 të Ligjit nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, në pajtim me nenin 65 të Ligjit Nr. 08/L -197 për Zyrtarët Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-294 si dhe neni 11 i Rregullores Nr.02/2024 për transferimin e nëpunësve civil, Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

Për transferimin e përhershëm për interes të institucionit

1. Z. Liridon Sadiku, Zyrtar i Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale, Drejtoria për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në pozitën: Zyrtar për Planifikimi, Licencim dhe trajnime në Departamentin për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare ne Ministrinë e Drejtësisë.
2. Nëpunësi sipas pikës 1 të këtij vendimi obligohet që detyrat dhe përgjegjësitë ti kryej në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.
3. Obligohet Divizioni për Burime Njerëzore dhe Divizioni për Buxhet dhe Financa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Me kërkesë të datës 07.11.2025 për transferim të përhershëm në interes të institucionit të pranuar nga Drejtori i Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Drejtësisë, është kërkuar nga Komuna e Prishtinës konfirmimi i pëlqimit dhe rrjedhimisht aprovimi i kërkesës për transferimin e përhershëm në interes të institucionit të Z. Liridon Sadiku, Zyrtar i Shërbimeve Sociale në Qendrën për Punë Sociale, Drejtoria për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës në pozitën: **Zyrtar për Planifikimi, Licencim dhe trajnime** në Divizionin për Planifikim, Licencim dhe Trajnim në Departamentin për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare në Ministrinë e Drejtësisë.

Me 24.11.2025 me nr. të protokollit 02-1791 Marrëveshjet për transferim të përhershëm të nëpunësit civil janë dërguar për aprovim në Komunën e Prishtinës dhe pas konstituimit të Kuvendit Komunal me 12.12.2025 është pranuar Marrëveshja e nënshkruar për transferimin e përhershëm të nëpunësit z. Sadiku. Gjithashtu, ky transferim bëhet në pajtim me pëlqimin e nëpunësit në fjalë.

Andaj, për të mundësuar përmbushjen e të gjitha detyrave dhe përgjegjësi që janë në kuadër të mandatit të Departamentit për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankesë në KPMSHCK, brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të tij.

Anita Kalanderi

Sekretare e Përgjithshme

Vendimi i'u dërgohet:

- Z. Liridon Sadiku;
- Kabinetit të Ushtruesit të Detyrës së Ministrit të Drejtësisë;
- Zyres së Sekretares së Përgjithshme;
- Departamentin për Politika të Shërbimeve Sociale dhe Familjare;
- Drejtoria për Mirëqenie Sociale, Komuna e Prishtinës;
- Departamentit për Buxhet dhe Financa;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Arkivit të MD-së.